



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 53/5 prot.

Tiranë, më 11.2.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Ngresi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.1.2021, është njoftuar vendimi nr. 324, datë 11.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Ngresi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ngresi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Sokol Ngresi”<sup>2</sup>, ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit fillestar mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol \*\*\* Ngresi, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol \*\*\* Ngresi”. Me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020<sup>3</sup>, DSIK ka përditësuar dhe ndryshuar konstatimin e bërë në raportin e parë, ku, pas referimit të disa informacioneve nga autoritetet verifikuese, e ka lënë në vlerësimin e Komisionit vlerësimin e tyre.

2.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>4</sup> për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ngresi.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe ka vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë prej*

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, drejtuar Komisionit.

<sup>3</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr.\*\*\*, datë \*\*\*.2.2020.

<sup>4</sup> Raport i KLGJ-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019.

*tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaratimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

*Trupi gjykues arsyeton se balancat negative të rezultuara nga analiza financiare e pasurive dhe e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në analizën e përfitësuar financiare, nuk është e një shkalle të tillë që të cenojë besimin e publikut. Vetë natyra e analizës financiare mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson. Ajo thjesht shërben si një tregues i të ardhurave të ligjshme, pasurive dhe shpenzimeve të jetesës për një periudhë kohe. Çdo analizë financiare, nga natyra e saj, është e përafërt dhe jo absolute.*

*Trupi gjykues konsideron se çdo mospërputhje në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit janë pasqyrim i analizës financiare të Komisionit. Si të tilla, mospërputhjet nuk arrijnë nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe as nuk ngrenë dyshime mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra [...] (f. 19 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Ngresi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

**3.2 Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës [...] (f. 20 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ngresi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e gjyqtarit Sokol Ngresi dhe, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, propozon për kriterin profesional vlerësimin “i aftë” [...] (f. 28 e vendimit). Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ngresi, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 324, datë 11.12.2020, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

- 5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).
- 6.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).
- 7.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
- 8.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.
- 9.** Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 324/2020, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohet në vijim, ky ankim i referohet jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor i procesit, që vendos për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit.
- 10.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarinin e subjektit për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi, si dhe (ii) deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtyre pasurive.
- 11.** Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.
- 12.** Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të tria kriteret e rivlerësimit.

### III. Analiza e shkaqeve të ankimit

#### III.A. Kontrolli i pasurisë

13. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato DV - periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ngresi, është bërë subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ai ka dorëzuar në vijimësi deklaratat e interesave private para fillimit të detyrës në vitet 2003 dhe 2009<sup>5</sup>, deklaratat periodike për vitet 2004 - 2006 dhe 2009 - 2016 dhe Deklaratën pas largimit nga funksioni, në vitin 2008 (për vitin 2007). Në zbatim të nenit 179/b, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në datën 27.1.2017, Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016.

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave para fillimit të detyrës, të deklaratave periodike vjetore dhe Deklaratës “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimeve të ligjshme të pasurive, rezulton si vijon:

#### 16. Pasuria - Apartament banimi me sipërfaqe 144.8 m<sup>2</sup>, në Vlorë

16.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi” me sip.144.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Z. K. \*\*\*, vol. \*\*\*, f.\*\*\*, në \*\*\*, Vlorë, pranë Portit Detar, porositur për ndërtim dhe blerje me kontratë porosie nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.11.2012, te shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.3.2015, nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Burimi i krijimit: (i) kredi nga \*\*\* Bank, në shumën 30.000 euro; (ii) kredi nga \*\*\*, në shumën 16.000 euro; (iii) kursime të grumbulluara në vite, në shumën 19.160 euro. Vlera: 65.160 euro. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

16.2 Në DV-2012, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sip.144.8 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Vlorë, pranë Portit Detar, i porositur për ndërtim dhe blerje me kontratë porosie nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.11.2012, të noterit \*\*\*.\*\*\*. Burimi i krijimit: (i) kredi nga \*\*\* Bank, në shumën 30.000 euro; (ii) kursime të grumbulluara në vite, në shumën 20.000 euro. Vlera: 65.160 euro. Pjesa takuese: 100%.

<sup>5</sup> Dorëzuar në datën 19.3.2010, pas rikthimit në detyrë me vendim të KLD-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2009.

16.3 Në DV-2015, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: Pagim i kështit për blerjen e banesës. Vlera: 8.000 euro. Burimi i krijimit: 4.000 euro nga kursimet e këtij viti dhe 4.000 euro nga kursimet e mëparshme.

16.4 Në DV-2016, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: Pagim i kështit të fundit për blerjen e banesës. Vlera: 7.160 euro. Burimi i krijimit: nga kursimet e këtij viti dhe nga kursimet e mëparshme.

16.5 ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, konfirmon se në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, rezulton e regjistruar pasuria e llojit apartament, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, faqe \*\*\*, Z. K. \*\*\*.

16.6 Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2012, dhe kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2015, lidhur midis shoqërisë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe z. Sokol dhe znj. \*\*\* Ngresi, në cilësinë e blerësit, me objekt: shitje apartamenti, në vlerën 65.160 euro, shumë kjo që është likuiduar e gjitha nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale, me këste, sipas dokumenteve bashkëlidhur kësaj kontrate.

16.7 Lidhur me mospërputhjen e konstatuar mbi burimet e deklaruara në Deklaratën Vetting dhe në atë DV-2012 (mbi përdorimin e shumës 16.000 euro, e përfitur me kredi bankare nga \*\*\*, në vitin 2007), Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

16.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, protokolluar në KPK me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2020, ka deklaruar se: [...]Shuma prej 16.000 euro, e përfitur me anë të kredisë bankare me destinacion blerjen e një apartamenti prej sipërmarrësit “\*\*\*” sh.p.k., e vitit 2007, e cila nuk është përdorur më tej, por është disponuar prej meje cash, është deklaruar nga ana ime si një pjesë e burimit për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 144.8 m<sup>2</sup>, e blerë prej sipërmarrësit “\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2015. Pavarësisht se kjo kredi është shlyer tërësisht nga unë dhe bashkëshortja ime, pra në thelb është pjesë e të ardhurave të mia, e kam identifikuar si të tillë për të qenë transparent dhe për të evidentuar burimin e kësaj shume në çastin e krijimit të saj dhe mënyrën e përdorimit përfundimtar të kësaj shume [...].

16.9 Lidhur me mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e blerjes së pasurisë me burime të ligjshme, për vitet 2012, 2014 dhe 2015, nga e cila ka rezultuar se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme pagesën e kryer në dhjetor të vitit 2014 dhe në shkurt të vitit 2015, në shumën totale - 542.856 lekë. Për këtë pamjaftueshmëri, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

16.10 Pas paraqitjes së provave dhe përgjigjeve mbi rezultatet e hetimit, depozituar nga subjekti në datën 3.12.2020, Komisionin përfundimisht ka vlerësuar se kjo diferencë negative nuk është në atë masë sa subjekti të konsiderohet fajtor dhe, për pasojë, të passjellë aplikimin e një mase disiplinore.

16.11 Komisioneri Publik çmon se ky konkluzion i Komisionit nuk bazohet në një interpretim të drejtë të të gjitha fakteve dhe provave të administruara në dosje, për arsytet si vijon:

16.12 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie ka kryer pagesat si vijon: (i) me mandatin datë \*\*\*.11.2012 është paguar shuma 20.000 euro pranë arkës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (ii) në datën \*\*\*.12.2012 është disbursuar në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, pranë \*\*\* Bank, shuma 30.000 euro dhe, në të njëjtën datë, kjo shumë është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin: “*kalim fondi për blerje apartamenti*”; (iii) me mandatin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2014, është paguar shuma 7.160 euro pranë arkës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (iv) me mandatin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2015, është paguar shuma 8.000 euro pranë arkës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

16.13 Në vijim do të trajtohen vetëm ato burime dhe të ardhura, që kanë shërbyer si pagesa për shlyerjen e çmimit për blerjen e kësaj pasurie, për të cilat, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, në interpretim të dispozitës së nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ndan një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni.

*16.13.1 Lidhur me pagesën e shumës 20.000 euro, datë \*\*\*.11.2012, me burim të deklaruar në DV-2012: kursimet ndër vite, nga verifikimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton se:*

- Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarimi për herë të parë në vitin 2003, ku, në përputhje me legjislacionin e kohës, ka plotësuar “*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*”, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 29.3.2004.
- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarimin e interesave private periodike vjetore deri në vitin 2006. Në datën 19.3.2008, ai ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën e interesave private pas largimit nga funksioni<sup>6</sup>.
- Me aktin e KLD-së nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2009, është realizuar rikthimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
- Pas rikthimit në detyrë, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën e interesave private periodike/vjetore (*para fillimit të detyrës, shënim me shkrim dore*) në datën 19.3.2010, në të cilën nuk rezulton të ketë deklaruar posedim të kursimeve në *cash*.
- Në deklaratat periodike pasuese, DV-2010 dhe DV-2011 (përpara pagesës së shumës 20.000 euro), nuk janë deklaruar ndryshime të kursimeve *cash*<sup>7</sup>.

16.14 Komisioneri Publik vlerëson se likuiditetet (si gjendje *cash*), në kuptim të ligjit, janë pasuri për të cilat subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin t'i deklaronte, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 5/1 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar.

16.15 Sa më sipër konstatohet se subjekti i rivlerësimit, përkundër parashikimit ligjor, nuk rezulton të ketë deklaruar posedim të kursimeve *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 19.3.2010.

<sup>6</sup> Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se është udhëzuar nga ILDKPKI të plotësojë vetëm një deklaratë që përfshin edhe interesat e vitit 2007, për sa kohë që është pezulluar nga funksioni i gjyqtarit me urdhër të KLD-së, datë 20.2.2008.

<sup>7</sup> Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë \*\*\*.11.2011, subjekti ka deklaruar se ka poseduar kursime në *cash*, në fund të vitit 2008, në shumën 34.000 euro, ndërsa në fund të vitit 2010 kursimet në *cash* ishin në shumën 36.000 euro (duke përfshirë në to dhe shumën e depozitës së tërhequr nga \*\*\* Bank, depozitë e krijuar me burim kredinë pranë \*\*\*), si dhe 1.400.000 lekë.

16.16 Nisur nga specifika e pasurisë: “kursime në cash”, deklarimi i tyre në deklaratat periodike vjetore merr rëndësi, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë që ka gjetur interpretim në edhe në jurisprudencën e Kolegjit. Në vendimin (JR) nr. 27, datë 22.10.2020, Kolegji arsyeton se: [...] *Në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit (shih vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.), në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe së bashku me Deklaratën “Vetting” përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit... ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar, dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e Deklaratës “Vetting” dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme [...].<sup>8</sup>*

16.17 Në këto rrethana, kur konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në cash në Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 19.3.2010, duket se subjekti i rivlerësimit nuk provon mbulimin me burime të ligjshme të shumës prej 20.000 euro, paguar në vitin 2012, si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit në Vlorë.

16.18 Edhe në vlerësim të kursimeve në cash, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004-2007, nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklarin e tij të parë, dorëzuar në datën 29.3.2004, ka deklaruar: *(i) prenotim apartament banimi, likuiduar kësti i parë në shumën 6.000 euro dhe (ii) depozitë bankare pranë \*\*\* Bank në shumën 350.000 lekë, si dhe (iii) të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes*. Nuk deklarohen kursime në cash.

16.18.1 Ndërkohë, në DV-2004, subjekti ka deklaruar: *(i) gjendje cash 18.000 euro, pjesa takuese ½, me burim kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes, për periudhën nga \*\*\*.2.1996 e në vazhdimësi dhe (ii) depozitë kursimi me afat 3-mujor, në shumën 450.000 lekë, pjesë takuese ½.*

16.18.2 Në aktet e fashikullit të hetimit administrativ, ndër të tjera, është administruar një akt shkresor, i titulluar “Sqarim”, i nënshkruar nga subjekti me datë 26.3.2007 dhe depozituar pranë ILDKPKI-së, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar; [...] *Në lidhje me deklaratën e përpiluar prej meje në vitin 2004 sqaroj se në rubrikën që kam deklaruar prenotimin e një banese dhe parapagimin e shumës 6.000 euro, këtë shumë e kam pas llogaritur si pjesë e kursimeve prej 18.000 euro, të deklaruar në vijim. Pra në shumën 18.000 euro përfshihet edhe shuma 6.000 euro, e dhënë si parapagim për prenotim banese, pasi pak kohë pas deklarinimit jam tërhequr nga kontrata e prenotimit për arsye moskorrektësie të*

---

<sup>8</sup> Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendime lidhur me deklarin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019 në prg. 84; (JR) nr. 20/2019 në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në prg. 31.



*firmës kontraktuese dhe shuma prej 6.000 euro është rikthyer dhe zotërohet si pjesë e kursimeve familjare [...].*

16.18.3 Lidhur me këto kursime *cash*, shpjegimet e subjektit dhënë në ILDKPKI dhe ato të dhëna në Komision gjatë hetimit administrativ, duket se janë kontradiktore, pasi, përveç sa më sipër, sipas procesverbalit datë \*\*\*.11.2011, subjekti ka deklaruar se për blerjen e një apartamenti në vitin 2007 kishte kursime *cash* në banesë rreth 18.000 euro, siguruar nga puna e tij dhe e bashkëshortes, në vite. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti, i pyetur mbi kursimet në *cash*, të deklaruara në DV-2004, në shumën 18.000 euro, ka deklaruar se: *vetëm 9.000 euro kanë qenë kursime të vetë subjektit dhe të bashkëshortes, ku përfshihet dhe shuma 6.000 euro, e kthyer nga parapagimi i deklaruar në DV-2003, dhe 3.000 euro kursime të vitit 2004, dhe për herë të parë ka deklaruar se pjesa tjetër, prej 9.000 euro, kanë qenë kursime të prindërve.*

16.18.4 Komisioni, pavarësisht sa më sipër, ka analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij për të krijuar nga burime të ligjshme shumën prej 18.000 euro me të ardhurat e viteve 1996-2003, nga ku i ka rezultuar se ato mbulohen me burime të ligjshme.

16.18.5 Komisioneri Publik, lidhur me kursimet *cash* në shumën 18.000 euro, të deklaruar në DV-2004, konstaton se:

- nuk rezulton që në DV-2004 subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar kthimin e parapagimit të shumës prej 6.000 euro nga prishja e kontratës së nënshkruar, datë \*\*\*.3.2004, midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- nuk identifikohet asnjë transaksion financiar që të provojë kthimin e kësaj shume;
- subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin dhe pjesën takuese të kursimeve në *cash në shumën 18.000 euro*, në deklaratat periodike vjetore, procesverbalet e depozituar në ILDKPKI-së, si dhe ato gjatë hetimit administrativ në Komision, duke krijuar pamundësi të institucioneve të rivlerësimit në verifikimin e burimeve të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre likuiditeteve në *cash*.

16.18.6 Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve të deklaruara në DV-2004, në shumën 18.000 euro, edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me kthimin e shumës 6.000 euro në këtë vit, rezulton se shtesa e kursimeve në vitin 2004, në shumën prej 12.000 euro (si diferencë midis gjendjes së deklaruar 18.000 euro dhe kthimit të parapagimit në shumën 6.000 euro) *nuk mbulohet me burime të ligjshme* të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, për një diferencë negative prej - 1.357.384 lekë.

16.18.7 Në deklaratën pas largimit nga detyra, dorëzuar në datën 19.3.2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament në ndërtim 1+1, me sip. 84 m<sup>2</sup>, prenotuar me kontratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë. \*\*\*.8.2007, nga firma ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma 33.000 euro, likuiduar kësti i parë me mandat arkëtimi nr. \*\*\* datë \*\*\*.8.2007, shuma 17.000 euro; kursime nga pagat 400.000 lekë; kredi e marrë në \*\*\* Bank, në shumën 16.000 euro, për pagimin e pjesës tjetër të apartamentit; likuidim i këstit të dytë të apartamentit, në shumën 16.000 euro, nëpërmjet tërheqjes së shumës së marrë kredi drejtpërdrejt nga \*\*\* Bank prej sipërmarrësit; rikthim i vlerës së këstit të dytë të*

apartamentit nga sipërmarrësi tek unë, deklaruesi, shuma 16.000 euro; depozitë në \*\*\* Bank, me afat 3-mujor të një pjesë të shumës së rikthyer nga sipërmarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma 15.000 euro; depozitë me afat 3-mujor (ripërsëritje e depozitës së mëparshme 3-mujore) pranë bankës \*\*\*, shuma 15.139,35 euro.

16.18.8 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit, kontratë premtim shitje nr. \*\*\* rep. nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2007, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për apartament me sip. 84 m,<sup>2</sup> kundrejt vlerës 33.000 euro. Në kontratë specifikohet se 17.000 euro paguhen në momentin e prenotimit, ndërsa kësti tjetër është në vlerën 16.000 euro. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ rezulton se shuma prej 16.000 euro, e financuar nga ana e \*\*\* Bank, në llogarinë e subjektit, në datën \*\*\*.10.2007, është transferuar në llogari të shitësit “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën \*\*\*.10.2007. Në datën \*\*\*.11.2007, shuma prej 15.655 euro është kthyer në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë \*\*\*, me urdhërues “\*\*\*\* SH P K KALIM FONDI”, dhe është tërhequr në cash shuma 15.000 euro, datë \*\*\*.11.2007. \*\*\* Bank, me shkresën nr. \*\*\*, datë \*\*\*.12.2019, konfirmon se në të njëjtën datë, shuma prej 15.000 euro, është depozituar cash në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë kësaj banke dhe, pasi është rinovuar së bashku me interesat, është tërhequr e plotë në datën \*\*\*.5.2008.

16.19 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nisur nga pamjaftueshmëria e konstatuar në mbulimin e kursimeve në cash, të deklaruara në DV-2004; mosdeklarimi në DV-2007 të kthimit të shumës 17.000 euro; si dhe mosdeklarimi në DV-2009 (në momentin e rikthimit në detyrë dhe rikthim si subjekt deklarimi) të posedimit të kursimeve në cash apo destinacionin e shumës së tërhequr me burim kredinë pranë \*\*\* Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kursimet cash në këto vite dhe, si rezultat, nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet e deklaruara të përdorura për pagesën e shumës 20.000 euro, në DV-2012.

16.20 Lidhur me dy pagesat e tjera për pasurinë nr.1, rezulton se në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagim i këstit të fundit për blerjen e banesës*. Vlera: 7.160 euro. Burimi i krijimit: *nga kursimet e këtij viti dhe nga kursimet e mëparshme*.

16.20.1 Sipas mandatit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2014, depozituar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., rezulton është paguar nga ana e subjektit shuma 7.160 euro.

16.20.2 Sa më sipër, rezulton se edhe pse pagesa sipas mandatit është kryer në vitin 2014, nuk është deklaruar nga subjekti në këtë vit, por në DV-2016.

16.20.3 Gjithashtu, në DV-2016, subjekti nuk ka saktësuar se cila pjesë e kursimeve të vitit paraardhës është përdorur për këtë pagesë.

16.20.4 Në analizë të burimit të ligjshëm që ka shërbyer për pagesën e këtij kësti, edhe nëse pakësojmë të gjitha kursimet në cash që dispononte subjekti në datën 31.12.2013<sup>9</sup>, rezulton se pagesa e kësaj shume dhe shpenzimet e vitit 2014, nuk mbulohen me burime të ligjshme dhe

---

<sup>9</sup> Shuma 960.000 lekë, nga të cilat 440.000 lekë kursime të vitit 2012 dhe 520.000 lekë kursime të vitit 2013.

subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit<sup>10</sup>.

16.21 *Lidhur me pagesën e shumës 8.000 euro*, sipas mandatit të arkëtimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2015, rezulton se në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për këtë pagesë: *4.000 euro nga kursimet e këtij viti dhe 4.000 euro nga kursimet e mëparshme*.

16.21.1 Mbi burimin: *“kursime të këtij viti”*, nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, rezulton se gjatë periudhës \*\*\*.1.2015 – \*\*\*.2.2015 është tërhequr në total nga llogaritë bankare, pranë të cilave kreditohen pagat mujore, shuma rreth 251.000 lekë. Edhe nëse pranohet se e gjithë shuma e tërhequr është përdorur për pagesën e pjesës takuese prej 4.000 euro, pa llogaritur këtu shpenzime jetese apo udhëtime për periudhën në fjalë, rezulton se tërheqjet në *cash* nuk mbulojnë vlerën e deklaruar për një diferencë negative prej - 309.440 lekë.

16.22 Në përfundim të analizës së provave dhe akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament me sip. 144.8 m<sup>2</sup>”, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë “Apartament me sip. 144.8 m<sup>2</sup>”.

## **17. Pasuria nr. 2, Automjet tip “Skoda Yeti”, me targa AA\*\*\*, në vlerën 14.500 euro**

17.1 *Në Deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar:* Automjet tip “Skoda Yeti”, me targa AA\*\*\*, blerë me datën \*\*\*.2.2010, nga shoqëria “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. *Vlera:* 14.500 euro. *Burimi:* (i) të ardhurat nga paga si avokat dhe gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes; (iii) 7.000 euro përfituar nga shitja e mjetit “Mercedes Benz”, me targa VK \*\*\*<sup>11</sup>. *Pjesa takuese:* 50% në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten.

17.2 *Në DV-2009 (që i korrespondon momentit të deklarimit të parë pas rikthimit në detyrë), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:* Blerje automjeti tip “Skoda Yeti”, me targa VL\*\*\*, në shkurt 2010, nga shoqëria “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. *Vlera:* 14.500 euro. *Pjesa takuese:* 50%. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shitje automjeti tip “Mercedes Benz”, me targa VL\*\*\*, në dhjetor 2009, për vlerën 5.000 euro (nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se ky automjet është shitur për shumën 7.000 euro, sikundër ka pranuar dhe subjekti gjatë hetimit administrativ)<sup>12</sup>.

17.3 Nga përgjigja e DPSHTRr-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, dhe materialeve bashkëlidhur, rezulton se shtetasit \*\*\* Ngresi dhe Sokol Ngresi kanë në pronësi mjetin tip “Skoda Yeti”, me targa AA\*\*\*. Për këtë pasuri rezulton se pagesa është bërë me dy këste, kësti i parë në shumën 3.500 euro, paguar në dhjetor të vitit 2009 dhe kësti i dytë, në shumën 11.000 euro, paguar në shkurt të vitit 2010.

<sup>10</sup> Rezultun se kjo pagesë nuk mbulohet me burime të ligjshme për një diferencë negative prej – 161.524 lekë.

<sup>11</sup> Subjekti në D. Vett., ka deklaruar: *Ky automjet është blerë prej meje dhe çmimi është paguar nga shtetasit \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, kushërinjtë e mi të parë, që jetojnë dhe punojnë në Itali, ndërkohë që prej meje është paguar vetëm vlera e zhdoganimit, në shumën 198.293 lekë.*

<sup>12</sup> Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje automjeti tip “Mercedes Benz E 200”, me targa VL\*\*\*, vit i prodhimit 1996. *Vlera:* 2.800 euro. *Pjesa takuese:* 100%. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: automjeti tip “Mercedes Benz E 200”, si dhuratë nga \*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* (djemtë e dajës), në vlerën 2.800 euro (subjekti nuk ka deklaruar vlerën e zhdoganimit, 198.293 ALL).

17.4 Komisioni, në vendimin e arsyetuar, konkludon se subjekti në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë automjet edhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të kryer dy pagesat për automjetin, në vitet 2009 dhe 2010.

17.5 Komisioneri Publik, për sa më sipër, ka vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, lidhur me burimin e deklaruar: shitje e automjetit të mëparshëm në vlerën 7.000 euro ose 960.190 lekë. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se ka paguar për këtë automjet në momentin e fitimit të pronësisë, në vitin 2006, vetëm shumën 198.293 lekë, për zhdoganimin e mjetit, ndërsa automjeti është dhuratë nga kushërinjtë e tij.

17.6 Referuar jurisprudencës të Kolegjit (vendimi 11/2019, prg. 27.12.12), lidhur me burimin e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie, në momentin e shitjes së automjetit të mëparshëm dhe përfitimit të shumës 7.000 euro, subjekti i rivlerësimit do të duhej të paguante tatim mbi fitimin, i realizuar nga shitja e këtij automjeti (*si diferencë midis çmimit të shitjes dhe vlerës së paguar për zhdoganimin e mjetit, në rastin konkret*) në mënyrë që të ardhurat e përfituara nga ky transaksion të konsiderohen të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Për sa më sipër, shuma prej 761.897 lekë<sup>13</sup> nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë autoveturë tip “Skoda Yeti”.

17.7 Nga aktet në dosje duket se Komisioni, në analizën financiare të kryer për vitet 2009 dhe 2010, ka pakësuar kursimet në *cash*, të padeklaruara si pakësime nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore respektive.

17.8 Nga analiza e deklarimeve periodike të subjektit konstatohet se në DV-2009, dorëzuar në datën 19.3.2010, kur ka deklaruar blerjen e automjetit, subjekti nuk ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie, pakësimin apo përdorimin e kursimeve të disponuara në *cash*.

17.9 Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit: (i) orientimin në vendimin (JR) 7/2019 (prg. 39) dhe vendimet: (a) (JR) 11/2019, prg. 27.12.18, (b) vendimi (JR) 19/2019 prg. 84., vlerëson se treguesit e analizës financiare të realizuar nga Komisioni, lidhur me gjendjen *cash*/kursimet ndër vite dhe burimet e deklaruara për blerjen e pasurisë, mund të bazohen vetëm mbi sa ka deklaruar subjekti në deklaratat periodike vjetore përkatëse, të cilat, sikundër argumentuam dhe më sipër, në pasurinë nr.1, kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit.

17.10 Për sa parashtruar më lart, pasuria automjet tip “Skoda Yeti”, blerë nga subjekti në vitin 2010, nuk mbulohet me burime të ligjshme, pasi, përveç gjetjeve lidhur me burimin: “*shitje e automjetit të mëparshëm në shumën 7.000 euro*”, edhe nga verifikimi i transaksioneve të llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, për periudhën \*\*\* janar – \*\*\*.2.2010, rezulton se është tërhequr në *cash* në total shuma prej 700.000 lekësh, e cila nuk mjafton për të mbuluar pagesën prej 11.000 euro (ose 1.472.860 lekë), në datën 19.2.2009 dhe, sikur të pranohet, që e gjithë shuma e tërhequr të jetë përdorur për këtë pagesë, pa llogaritur këtu shpenzime jetese për familjen.

---

<sup>13</sup> Vlera e shitjes e konvertuar në lekë në fund të vitit 2009, e barabartë me 960.190 lekë – vlerën e paguar për zhdoganim në vitin 2006, prej 198.293 lekë.

## **18. Pasuria nr. 3, Autoveturë “Fiat”, me targa AA\*\*\***

18.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Automjet tip “Fiat”, me targa AA\*\*\*, prodhim i vitit 2008, blerë me datën \*\*\*.9.2008, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Vlera: 8.800 euro. Burimi: (i) të ardhurat nga paga e tij si avokat dhe gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes; (iii) 500.000 lekë, përfituar nga shitja e mjetit “Mercedes Benz”, me targa VL\*\*\*. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten.

18.2 Në DV-2009 (deklarata para fillimit të detyrës), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 19.3.2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje automjeti tip “Fiat”, me targa VL\*\*\*, në \*\*\*.9.2008, nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. Vlera: 8.800 euro. Pjesa takuese: 50%. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shitje automjeti tip “Mercedes Benz”, me targa VL\*\*\*, në qershor 2008, për vlerën 6.300 euro.

18.3 Nga përgjigjja e DPSHTRR-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, dhe akteve bashkëlidhur, rezulton se shtetasit \*\*\* dhe Sokol Ngresi kanë pasur në pronësi mjetin me targa TR\*\*\*. Gjithashtu, me këtë korrespondencë, konfirmohet në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij automjet tip “Fiat”, me targa AA\*\*\*, prodhim i vitit 2008.

18.4 Nga analiza, Komisionit i ka rezultuar se: [...] subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit, me kursimet nga të ardhurat nga paga shumë prej 8.800 euro dhe subjekti ka pasur mjaftueshëm kursime cash për të paguar shumën e reflektuar edhe në uljen e kursimeve cash në analizën financiare [...].

18.5 Edhe për sa më sipër, vlerësohet se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është në interpretim të drejtë të ligjit dhe akteve të administruara.

18.6 Lidhur me burimin e deklaruar nga subjekti, 500.000 lekë të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm, në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje automjeti tip “Mercedes Benz”, i vitit 1998, me targa TR\*\*\*. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

18.7 Nga vlerësimi i akteve në dosje rezulton se ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën \*\*\*.1.2006, me kontratë nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., është deklaruar nga subjekti në DV-2005 dhe jo në DV-2006. Nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në këtë deklaratë periodike burimi i të ardhurave për blerjen e tij apo pakësimi i kursimeve në cash.

18.8 Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit mbulon me burime të ligjshme në vitin 2006 shpenzimet, investimet dhe kursimet e këtij viti.

18.9 Konstatohet se Komisioni, gjatë kryerjes së analizës financiare, duket se nuk ka marrë në konsideratë balancat e llogarive të bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 66.014 lekë, pranë \*\*\* Bank, në datën 31.12.2006 dhe një depozitë të kësaj të fundit pranë \*\*\* Bank, gjendje, në datën 31.12.2006, në shumën 150.000 lekë, teprica të cilat do të ndikonin në ndryshimin e rezultatit financiar të këtij viti, duke çuar në pamjaftueshmëri financiare të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet e vitit 2006, përfshirë këtu edhe blerjen e automjetit, shitja e të cilit ka shërbyer në vijim si një nga burimet e blerjes së automjetit “Fiat”.

19. Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në konkluzionet e mësipërme mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga

neni D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**20.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe të provave në rastin konkret, dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

**21.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**22.** Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, neni 4, pika 2, dhe neni 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

**23.** Komisioneri Publik kërkon, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ngresi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**